



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1493 prot.

Shkodër, më 27.01. 2026

VENDIM
Nr. 6, datë 26.01.2026

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE –
EKONOMIA KULLOSORE “ROSEK–RRJOLL

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 26.01.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 27, pika 5, dhe nenin 54, shkronja “k”, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; nenin 11, pika 2/b, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, i ndryshuar; nenin 14 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për fondin kullosor”, të ndryshuar; si dhe VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-komunave/bashkive”, të ndryshuar; si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për Ekonominë Kullosore “ROSEK–RRJOLL”, Bashkia Shkodër, i cili do të jetë i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 37 vota

Vota Pro	37
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	27.01.2026

SEKRETARE

Sabina Dana



Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al